

Paramahansa Jogananda

Rubaijat e Omar Khajamit 51-75

interpretim shpirtëror
nga përkthimi i Edward FitzGerald-it
i Rubaijat-eve (katërvargësheve)

zgjedhi dhe shqipëroi Ridvan Bunjaku

tetor 2023

Përmbajtja

Rubaijat e Omar Khajamit (me interpretime).....	4
51	4
52	5
53	6
54	7
55	8
56	9
57	10
58	11
59	12
60	13
61	14
62	15
63	16
64	17
65	18
66	19
67	20
68	21
69	22
70	23
71	24
72	25
73	26
74	27
75	28

Rubaijat e Omar Khajamit (vetëm vargjet).....	29
51	29
52	29
53	29
54	30
55	30
56	30
57	31
58	31
59	31
60	32
61	32
62	32
63	33
64	33
65	33
66	34
67	34
68	34
69	35
70	35
71	35
72	36
73	36
74	36
75	37
Për botimin	38
Bibliografia	38
Online	38
Licensimi	38

Rubaijat e Omar Khajamit (me interpretime)

51

*Gishti Lëvizës shkruan; dhe, pasi shkroi,
Vazhdon tutje: as gjithë Devotshmëria as Urtia jote
S'do ta joshin ta anulojë as gjysmë Vije,
As tërë Lotët e tu s'do ta shlyejnë asnjë Fjalë të tij.*

FJALOR:

Gishti Lëvizës shkruan: Ligji Kozmik, që është i kudo-pranishëm dhe aktiv në tërë krijimin, e cakton dhe e drejton rendin natyror të të gjitha gjërave e krijesave, dhe e rregullon fatin e njeriut sipas karmës së tij individuale (rezultatet nga veprimet e tij në të shkuarën).

Pasi shkroi, vazhdon tutje: Vepron pandërprerë për ta caktuar rrjedhën e çasteve në jetën e njeriut dhe në ciklet e universit.

As gjithë Devotshmëria jote as Urtia s'do ta joshin ta anulojë as gjysmë Vije: As ofertat morale as ato intelektuale nuk mund zbusin ligjin kozmik duke e marrë me të mirë.

As tërë Lotët e tu s'do ta shlyejnë asnjë Fjalë të tij: Po ashtu, as lotët e frikës të njeriut as pikëllimi i pishmanit nuk mjaftojnë ta ndryshojnë rendin kozmik; as t'i zhdukin efektet e drejta karmike të shkaqeve të të shkuarës që ai vetë i ka vënë në lëvizje.

52

Dhe ai Tas i përmbysur që e quajmë Qielli

Nën të cilin, të kafazuar e duke u zvarritur rrojmë e vdesim,

Mos i ço duart kah Ai për ndihmë – se Ai

Vepron pa ndikim si Ti apo Unë.

FJALOR:

Tas i përmbysur që e quajmë Qielli: Kulmi qiellor i kufizuar në një formë si të gjitha gjërat e krijuara.

Mos i ço duart kah Ai për ndihmë: Mos prit që ndikimet astrologjike të ndihmojnë në ndryshimin e fatit tënd. Modeli simbolik planetar i lindjes tënde është nxjerrë nga veprimet e tua të shkuara. Mos i thirr asnjë fuqie të jashtme apo mjedisore, por Krijuesit të qiejve dhe të tokës, për çlirim dhe liri të vërtetë.

53

Me Argjilën e parë të Tokës Ato e bënë brumin e Njeriut të Fundit,

Dhe pastaj nga Korrja e Fundit e mbollën Farën:

Po, Mëngjesi i parë i Krijimit e shkroi

Atë që do të lexohet tek Agu i Fundit i Llogarisë.

FJALOR:

Me Argjilën e parë të Tokës: Me shpirtrat e parë të mishëruar që, të joshur nga tundimet shqisore të tokës, u kapën në lidhjet karmike të merakeve materiale dhe të veprimeve të gabuara.

Ato: Efektet e merakeve dhe të veprimeve.

E bënë brumin e Njeriut të Fundit: Nga njeriu i parë tek i fundit, ligji i karmës e formëson secilin mishërim aktual të personit, në një proces të shndërrimit të parimeve primare përmes cikleve në zhvillim deri kur shpirti i individualizuar e rimerr njëshmërinë e tij me Shpirtin.

Nga Korrja e Fundit: Nga efektet e grumbulluara të jetës së njeriut të ruajtura në vetëdijen e tij gjatë gjendjes pas-vdekjes ndërmjet mishërimeve.

E mbollën Farën: E mbollën farën e karmës dhe të merakeve në tokën e një mishërimi të ri.

Mëngjesi i parë i Krijimit: Shfaqja zanafillëse e Shpirtit Hyjnor në materie.

Agu i Fundit i Llogarisë: Mishërimi aktual i secilit njeri gjersa i merr efektet, apo gjykimin, e karmës së tij të shkuar.

54

*Ja ku po ta them – Kur, duke ia nisur nga Qëllimi,
Mbi supet e Mëzit flakërues
Të Qiellit e Paruinit e Mushtarës u hodhën,
Në Komplotin tim të destinuar të Pluhurit e Shpirtit.*

FJALOR:

Duke ia nisur nga Qëllimi: Duke rrjedhë nga Zoti, I Cili është Qëllimi i krijimit evolucionar si dhe Burimi i tij.

Mbi supet e Mëzit flakërues: Hipur mbi hamshorin e energjisë së zjarrtë kozmike. (Pegazi [Pegasus], Kali me Krahë, është një yjësi veriore në qiell, nën Plejadat dhe afër pikës së ekuinoksit pranveror. Omeri ishte astronom i aftë.)

Paruinit e Mushtarës: Termat persianë për Plejadat dhe Jupiterin. Plejadat e përmbajnë Alkionin (Alcyone), yllin që të lashtët e konsideronin si strumbullari qendror i universit. Jupiteri është planeti i njohjes intuitive shpirtërore.

Pluhurit e Shpirtit: Njeriut që si krijesë është pluhur, sepse i nënshtrohet kufizimeve të krijimit apo të natyrës, por që si shpirt është përtej çdo nënshtrimi, një me lirinë e përhershme të Krijuesit.

55

*Vreshta e kishte nxjerrë një Fije; që sillet
E i kacavirret Qenies sime – le të përbuzet Sufiu;
Nga Metali im Bazë mund të gdhendet një Çelës,
Që do ta hapë Derën që ai e ulërin përjashta.*

FJALOR:

Vreshta: Vetëdija dhe forca e jetës që e përshkon shtyllën kurrizore. Shtylla kurrizore është si një pemë, me rrënjët lart në tru, dhe degët e nervave dalëse dhe hyrëse – poshtë. Vreshta e vetëdijes në njeriun e zakonshëm është e mbjellë në meraket tokësore në trurin dhe shqisat dhe duhet të transplantohet në tokën e vetëdijes hyjnore.

E kishte nxjerrë një Fije: E kishte nxjerrë një rrënjë të re në tokën e Vetëdijes Kozmike.

I kacavirret Qenies sime: Jogi meditues e gjen vetëdijen e tij duke u kacavjerrë rreth regionit të shtyllës kurrizore ku mbretërojnë forcat më të mira dhe vetëdija-e-Zotit.

Le të përbuzet Sufiu: Omari nuk e ka përdorur fjalën “Sufi” në këtë strofë, meqë Omari vetë ishte Sufi (anëtar i një sekti fetar të devotshëm që përfshin shumë shenjtorë të mëdhenj). FitzGerald-i, përkthyesi i Omarit, e ka përdorur fjalën “Sufi” këtu, duke e identifikuar gabimisht një Sufi si materialist. FitzGerald-i e hoqi fjalën “Sufi” në të gjitha botimet e mëvonshme.

Metali im Bazë: Substanca e çmuar e jetës e abuzuar nga shprehitë materiale.

Të gdhendet një Çelës: Çelësi i Realizimit-(rrokjes, kuptimit)-të-Vetes i formësuar nga meditimi.

Që do ta hapë Derën: Që do t’i hapë shufrat e burgut trupor për në mbretërinë e lirisë kudo-prezente në perceptimin-e-Zotit. Përmes teknikave të meditimit perceptimi-trupor i kufizuar shndërrohet në perceptimin-e-Zotit që është i pakufizuar.

Që ai e ulërin përjashta: Teologu i ngurtë, apo një person që është veç teorikisht fetar dhe nuk e jeton jetën e vërtetë shpirtërore, tallet me mundësinë e realizimit-personal-të-Zotit; ai mbetet “përjashta” në vetëdijen materiale me dyshimet, frikat dhe pakënaqësinë e saj, i paaftë për të hyrë në qiellin e brendshëm të shkrirjes-me-Zotin dhe të perceptimit të drejtpërdrejtë të së vërtetës.

56

*Dhe këtë unë e di: nëse ajo Drita e Vërtetë,
Zjarri i Dashurisë, apo Zemërimi më konsumojnë goxha,
Një shfaqje e rrufeshme e Saj brenda Tavernës e kapur
Është më mirë se në Tempull i humbur krejt.*

FJALOR:

Këtë unë e di: Saktësia e sigurt e intuitës së pagabueshme.

Ajo Drita e Vërtetë: Zotëruesi si Urti Hyjnore, ajo urtia e vetme në kontrast me intelektualizimet e rreme të shumanshme të botës.

Zjarri i Dashurisë: Përshpejtimi, përmes kontaktit hyjnor, i dashamirësisë e i dhembshurisë universale dhe i merakut për t'u shërbyer të gjithëve e të gjithave.

Apo Zemërimi më konsumojnë goxha: Apo kontakti hyjnor mund të krijojë në mua pakënaqësi me gjithçka të zakonshme e jointeressante, dhe prandaj ta ngjallë një merak ta braktis tokësoren dhe të gjitha gjërat materiale. Urtia hyjnore e lind Realizimin-(rrokjen, kuptimin)-e-Vetes duke e konsumuar ndjenjën e “unë-it” apo egon.

Një shfaqje e rrufeshme e Saj: Një shfaqje e rrufeshme (blic) e Hyjnores në meditim.

Brenda Tavernës: Në hanin e karvaneve të jetës tokësore dhe të trupit të vdekshëm, ku shpirti, mendimet, dhe përjetimet bëhen bashkë për ca kohë.

Në Tempull i humbur krejt: Të humbesh në kurthet teologjike e ceremoniale të religjionit, duke mos ëndërruar kurrë ta kontaktosh vërtet Zotin, Banuesin në tempujt E Tij. Ata që e kalojnë jetën e tyre thjesht duke e diskutuar teologjinë janë “të humbur krejt” nga rruga e Realizimit-(rrokjes, kuptimit)-të-Zotit.

57

*Oh, Ti, që me Gropën e Kurthit dhe me Xhinin
Ma bllokove Rrugën në të cilën do të endesha,
A nuk do të më kapësh në Rrjetë me raund të Paracaktimit,
Dhe t'ia atribuosh Rënien time Mëkatit?*

FJALOR:

Ti: Pseudo-shpirti i udhëzuar gabimisht apo egoja.

Me Gropën e Kurthit: Me lakun e injorancës dhe të moçaleve mendore të shprehive të gabuara nga të cilat është shumë vështirë ta çlirosh shpirtin.

*Me Xhinin:*¹ Me kënaqësitë shqisore, dehja me të cilat e trullos vetëdijen e aspirantit shpirtëror.

Ma bllokove Rrugën në të cilën do të endesha: Ma pengove rrugën e urtisë dhe të Realizimit-(rrokjes, kuptimit)-të-Vetes.

Të më kapësh në Rrjetë me raund të Paracaktimit: Me ide false të përpiqesh të më mbash të palëvizshëm dhe të lidhur me gabimet e mija, duke më bërë të mendoj se Zoti ma ka paracaktuar të jem i burgosur i së keqes apo i ligjit të karmës.

Dhe t'ia atribuosh Rënien time Mëkatit: “Ta vendosësh qerren para kalit”, d.m.th.. ta përmbysësh (ta kthesh mbrapsht) postulatit e etabluar të shkakut e të pasojës. Meqë tendencat e mira apo të këqija karmike nuk mund të shfaqen pa u pasë zhvilluar fillimisht përmes zgjedhjes së lirë të njeriut, secili person është përgjegjës për fatin e tij.

¹ Pijen alkoolike

58

*Oh, Ti, që e bëre Njeriun nga Toka më e ulët,
Dhe që Me Edenin e sajove Gjarprin;
Për tërë Mëkatin nga i cili Fytyra e Njeriut
Nxihet, Faljen e Njeriut jepe – dhe merre!*

FJALOR:

Ti: Satani i Injorancës.

Njeriun: Qeniet, të krijuara sipas konceptit (shëmbëlltyrës) së Zotit.

E bëre nga Toka më e ulët: E shndërrove njeriun hyjnor në qenie inferiore tokësore.

Me Edenin: Me gjendjen e pastër të lumturisë origjinale.

E sajove Gjarprin: E shpikë forcën e mbështjellë të energjisë krijuese që rrjedh përjashta në trup nga një qendër subtile në bazën e shtyllës kurrizore, duke e zgjuar seksin dhe shqisat për ta zëvendësuar vetëdijen e ekstazës hyjnore që rrjedh përbrenda, dhe shkrirjen me Zotin.

Për tërë Mëkatin: Për shkeljet kundër ligjeve shoqërore dhe hyjnore që dalin nga nënshtrimi ndaj tundimeve të Satanit, dhe që rezultojnë në pasoja të tmerrshme karmike.

Fytyra e Njeriut nxihet: Natyra e vdekshme e njeriut përdhohet dhe errësohet me injorancë, duke e turbulluar imazhin hyjnor të shpirtit përbrenda.

Faljen e Njeriut jepe – dhe merre: Njeriu nuk duhet t'ia atribuojë tërë fatkeqësinë e tij Deluzionit Kozmik, por ta fajësojë edhe përgjigjen e vet ndaj tij. Por Deluzioni Satanik duhet të pranohet si faktor i madh në mbajtjen e njeriut subjekt të tundimeve shqisore; prandaj gjykimi i njeriut sipas ligjit karmik nuk duhet të bëhet pa e përdorur njëfarë mase të dashamirësisë e të dhembshurisë.

59

*Dëgjo përsëri. Një mbrëmje në Përmbyllje
Të Ramazanit, para se të dilte Hëna më e mirë,
Në atë Shitore të vjetër të Poçarit rrija vetëm
Me Popullatën e argjiltë përreth në Rreshta.*

FJALOR:

Të Ramazanit: Të muajit të shenjtë Islamik të lutjeve e agjërimit me qëllim që të kontaktohet Zoti; në këtë katërvargësh, duke e simbolizuar meditimin.

Para se të dilte Hëna më e mirë: Para se të hapej syri i brendshëm shpirtëror.

Në atë Shitore të vjetër të Poçarit: Në krijimin e Zotit.

Rrija vetëm: Mbeta në vetminë e jashtme të qetësisë.

Me Popullatën e argjiltë: Me vdekatarët, që e pësojnë vdekjen dhe ndryshimin, që jetojnë veç shkurt në tokë.

Përreth në Rreshta: Fazat e ndryshme karmike të zhvillimit të njeriut që e përcaktojnë vendosjen e tij aktuale në botë.

60

Dhe, për çudi, ndër ata të Turmës Tokësore

Disa mund të shpreheshin lehtë, e të tjerë jo:

Dhe befas një më i paduruar klithi –

“Kush është Poçari, ju lutem, e kush Poçi?”

FJALOR:

Ndër ata të Turmës Tokësore: Ndër individët e panumërt të lindur në tokë.

Disa mund të shpreheshin lehtë: Disa njerëz mund të flasin me urti.

E të tjerë jo: Të tjerë jetojnë në injorancë të errët.

Një më i paduruar: Një i gjallëruar nga shqyrtimi i brendshëm dhe uria shpirtërore.

Poçari: Krijuesi i qenieve njerëzore.

Poçi: Ena trupore.

61

*Pastaj tha një tjetër – “Sigurisht jo më kot
Substanca Ime nga Toka e zakonshme u mor,
Që Ai që në mënyrë subtile më bëri si Trajtë
Të më fuste në Tokën e zakonshme prapë.*

FJALOR:

Pastaj tha një tjetër: Një tjetër kërkues në pyetjet e Së Vërtetës.

Substanca Ime: Elementet kimike dhe minerale të trupit tim.

Nga Toka e zakonshme: Nga toka, që është burimi i përbashkët i të gjithë trupave fizikë dhe i substancave të tyre.

Ai që në mënyrë subtile më bëri si Trajtë: Krijuesi që me urtinë e pafund e formoi, e kimikalizoi dhe e gjallëroi trupin e njeriut nga balta e ftohtë, ashtu që të shkëlqente me jetë.

Të më fuste në Tokën e zakonshme prapë: Të ma kthente trupin në argjilën e paformë tokësore nga e cila formohen të gjithë trupat dhe në të cilën treten prapë përfundimisht.

62

*Një tjetër tha – “Epo, kurrë një Djalë me disponim të keq
Nuk do ta thyente Kupën nga e cila pinte me Gëzim;
Athua Ai që e bëri Enën në Dashuri të pastër
Dhe Dekorim Artistik, pas një Tërbimi do ta shkatërrojë?!”*

FJALOR:

Një tjetër tha: Një tjetër person arsyeton (rezonon).

Ai që e bëri Enën: Zoti që e krijoi trupin, enën e jetës.

Në Dashuri të pastër dhe Dekorim Artistik: Me dashurinë e Tij të madhe hyjnore dhe me imagjinatën e butë.

Pas një Tërbimi do ta shkatërrojë?!: Vuajtja dhe vdekja nuk i atribuohen Atit dashës të të gjithëve, të cilit gabimisht ia mveshim zemërimet e njeriut.

63

Askush s'iu përgjigj kësaj; por pas Heshtjes foli

Një Enë e ndërtuar më pahijshëm:

“Ata më përqeshin se jam anuar krejt e çrregullt;

Çka?! A u drodh pra Dora e Poçarit?”

FJALOR:

Një Enë e ndërtuar më pahijshëm: Një individ i pakëndshëm apo i lig.

Se jam anuar krejt e çrregullt: Për shkak të deformimeve të mia mendore e fizike.

Çka?!: Pse është faji im që kam defekte të tilla?

A u drodh pra Dora e Poçarit?: A nuk është njëfarë gabimi që Krijuesi im më bëri kështu?

64

*Tha njëri – “Njerëzit e një Banakieri qejfprishur tregojnë,
Dhe ia shkarravisin fytyrën me Tymin e Ferrit;
Flasin për njëfarë Sprove të rreptë ndaj nesh – Uha!
Ai është Mik i Mirë, dhe gjithçka do të jetë në rregull.”*

FJALOR:

Njerëzit e një Banakieri qejfprishur: Qeniet njerëzore që e konceptojnë Krijuesin e tyre si sprovues krenar të njerëzve – shpërndarës i gjykimeve të ashpra, që nxjerr gllënjka të hidhura nga fuçitë (kazanet) e jetëve njerëzore.

Ia shkarravisin fytyrën me Tymin e Ferrit: E paramendojnë Krijuesin si Zot të hakmarrjes dhe të zemërimit.

Flasin për njëfarë Sprove të rreptë ndaj nesh: Njerëzit injorantë thonë se është Krijuesi ai që shkakton që fëmijët e Tij të vuajnë duke shkaktuar sprova mizore.

Gjithçka do të jetë në rregull: Gjersa bukuritë e krijimit flasin për mirësinë e Krijuesit, le ta zhvillojmë besimin, me përjetim në realizim-(rrokje, kuptim)-të-Zotit, se të gjitha gjërat e krijuara lëvizin kah një qëllim hyjnor i lumturisë.

65

*Pastaj tha një tjetër me një Psherëtimë të zgjatur,
“Argjila ime me kllapinë time të gjatë është tharë:
Por, mbushmë me Lëngun e vjetër të njohur,
Më duket se mund të shërohem dikur!”*

FJALOR:

Me një Psherëtimë të zgjatur: Me një shprehje të një përpjekjeje të guximit të shfaqur për ta kapërcyer një problem të vështirë.

Argjila ime: Shpirti im i pavdekshëm i lashtë që, përmes shumë mishërimeve të shkuara, identifikohet me një formë fizike të vdekshme dhe me perceptimet dhe meraket e tij materiale.

Me kllapinë time të gjatë është tharë: Me harresë të gjatë të natyrës hyjnore të shpirtit gjersa ajo kalonte nëpër zyrtësitë dhe gëzimet e jetëve të shkuara.

Mbushmë me Lëngun e vjetër të njohur: Më mbush me urtinë intuitive primordiale (shumë të hershme) kaq të njohur për shpirtin, dhe të fshehur thellë brenda tij.

Më duket se mund të shërohem: Kështu mund ta rifitoj kujtimin tim të humbur të vetëdijes sime të vërtetë të shpirtit për përsosmëri e lumturi.

Dikur: Gradualisht, përmes përpjekjes së qëndrueshme shpirtërore.

Dhe gjersa Enët një nga një po flisnin,

Njëra e vërejtë Gjysmëhënën e vogël që të gjithë po e lypnin:

Dhe pastaj e shtynë njëri tjetrin: “Vëlla, Vëlla!

Vërja veshin kërcitjes së epoletës në supin e Derëtarit!”

FJALOR:

Enët: Qeniet njerëzore reflektuese; mbajtësit truporë të shpirtave të gjith-urtë.

Po flisnin: Po i shqyrtonin mendimet e ndjenjat e veta.

Njëra e vërejtë Gjysmëhënën e vogël: Njëra e perceptoi në zhytje të thellë përbrenda syrin shpirtëror të gjithëdijsëm të dritës astrale (aur-ale).

Që të gjithë po e lypnin: Atë që të gjithë ata që e kanë merak realizimin (rrokjen, kuptimin) e të vërtetës po e kërkojnë, me vetëdije apo pa vetëdije: syrin shpirtëror të urtisë me perceptimin e tij intuitiv të gjithëdijsëm.

Vërja veshin: Dëgjoje me vëmendje të thellë.

Kërcitjes: Tingullin e Vibrimit Kozmik, fuqinë krijuese të Zotit dhe të jetës kozmike përgjegjëse për krijimin universal dhe mbështetjen e jetës njerëzore.

Së Epoletës² në supin e Derëtarit: Të Zotit, Transportuesit Hyjnor që i bart në sup tërë enët njerëzore, të cilat Ai i ka lidhur dhe ndërthurur me jetën vibruese universale.

² Gradës, zburimit mbi supet e uniformave

67

*Ah, jeta ime që po shuhet, me Rrushin furnizo
Dhe ma laj Trupin prej nga Jeta ka vdekur,
Dhe në një Qefin të Gjetheve të hardhisë mbështjellë,
Kështu më varros krah një Kopshti të ëmbël.*

FJALOR:

Me Rrushin: Me perceptimin kozmik.

Jeta ime që po shuhet – furnizo: Më përtërij me rininë, freskinë-e-përhershme, të Shpirtit.

Ma laj Trupin prej nga Jeta ka vdekur: Me urti hyjnore laje vetëdijen time të egos, në të cilën meraket materiale janë tretur.

Në një Qefin të Gjetheve të hardhisë mbështjellë: I mbrojtur nga fuqia e perceptimit hyjnor.

Më varros: Ma mbaj egon fizike nën kontrollin e Shpirtit.

Krah një Kopshti të ëmbël: Në gëzimin e vetëdijes kozmike, në të cilën vëllazëria universale – njëshmëria me tërë jetën – përjetohet ëmbëlsisht.

68

*Ashtu që edhe Hiri im i varrosur si një Kurth
I Parfumit do të hidhet në Ajër,
Jo si Besimtar i Vërtetë që kalon atypari
Po do të kapet i pavetëdijshtëm.*

[Vazhdim i konceptit në strofën e mëparshme]

FJALOR:

Hiri im i varrosur: Egoja ime e spiritualizuar apo hyjnore – mbetja e esencës së pastruar të egos sime fizike të konsumuar nga Shpirti – që pushon në kopshtin e vetëdijes kozmike.

Si një Kurth I Parfumit do të hidhet: Do ta lëshojë një aromë kaq mahnitëse shpirtërore.

Në Ajër: Në ambientin tim.

Jo si Besimtar i Vërtetë: Jo si Kërkues i Zotit.

Që kalon atypari: Që bie në kontakt me mua edhe rastësisht.

Do të kapet i pavetëdijshtëm: Në mënyrë subtile do të magjepset dhe do të tërhiqet kah Zoti nga aroma hyjnore e vetëdijes sime universale të Zgjeruar-Shpirtërisht.

69

Vërtet Idhujt që i kam dashur kaq gjatë

I kanë bërë shumë padrejtësi Meritës sime në Syrin e Njerëzve:

Ma kanë zhytur Nderin në një Kupë të cekët,

Dhe ma shitën Reputacionin për një Këngë.

FJALOR:

Idhujt: Emri, fama, kënaqësitë shqisore – objektet e frikë-respektit të egos.

I kanë bërë shumë padrejtësi Meritës sime në Syrin e Njerëzve: Ma kanë turbulluar mua dhe të tjerëve natyrën time reale shpirtërore që ka fuqi të pakufizuara dhe lumturi qiellore.

Ma kanë zhytur Nderin në një Kupë të cekët: Ma kanë zhytur respektin për veten – duke e zhdukur aftësinë hyjnore të shpirtit tim për dallim të të mirës e të keqes – në dehjen e kënaqësive shqisore të kufizuara, të pakënaqshme.

Dhe ma shitën Reputacionin për një Këngë: Ma shkatërruan aftësinë dalluese të shpirtit tim për urti sublime, duke më bërë të vallëzoj me melodinë e tundimeve të pavlera.

70

Vërtet, vërtet, Pendesë shpesh para

Se të betohem – por a isha esëll kur u betova?

E pastaj e pastaj erdhi Pranvera, dhe Trëndafili-në-dorë

Pendimi im i stërarnuar u gris copë-copë.

FJALOR:

Pendesë shpesh para se të betohem: Pishmane që jam bërë skllav i shqisave; duke u betuar të heq dorë nga të gjitha dobësitë e brendshme.

Por a isha esëll ku u betova?: Por tash po mendoj se isha veç për një çast i dehur me dehësin jetëshkurtër të pendesës e të brejtjes së ndërgjegjes.

E pastaj e pastaj erdhi Pranvera: Tundimet e freskëta shfaqeshin gjithnjë e më shumë.

Trëndafili-në-dorë: Duke ofruar shpresa të trëndafilita të kënaqësive të reja.

Pendimi im i stërarnuar u gris copë-copë: Pikëllimi im për mëkatet e mija, i ripërsëritur e i stërpërdorur, u shqye edhe një herë.

71

*Dhe sado që Vera ka luajtur me Jobesimtarin,
Dhe ma grabiti Rrobën time të Nderit – epo,
Shpesh them athua çka blejnë Vreshtarët
Një gjysmë kaq të çmuar sa Mallrat që i shesin.*

FJALOR:

Vera: Dehja hyjnore.

Ka luajtur me Jobesimtarin: Më bëri të heq dorë nga besnikëria ime për t'i ndjerë lajkat.

Ma grabiti Rrobën time të Nderit: Më privoi nga lavdërimet e miqve të dikurshëm të çmendur për kënaqësi me të cilët pinim e kënaqeshim shumë zhurmshëm.

Vreshtarët: Ata që me shtypjen e verës së meditimit i prodhojnë ca gllënjka të realizimit (rrokjes, kuptimit) shpirtëror.

Mallrat që i shesin: Perceptimin-e-Zotit që e humbin në këmbim të përvetësimit të kënaqësive shqisore.

72

Sa keq që Pranvera duhet të shuhet me Trëndafilin!

Që Dorëshkrimi erëmirë i Rinisë duhet të mbyllet!

Bilbili që ndër Degë këndonte,

Ah, nga erdhi, dhe kah fluturoi përsëri, kush e di!

FJALOR:

Sa keq që Pranvera duhet të shuhet: Sa keq që merakët tokësorë rinorë duhet të dëbohen

Dorëshkrimi erëmirë i Rinisë: Marrëzitë rinore, dhe ëndrrat e ambicjet e ëmbla të regjistruara në faqet e gjalla të trurit.

Duhet të mbyllet: Hiqet dorë nga to.

Bilbili: Urtia.

Nga erdhi: Nga Shpirti i përhershëm.

Kah: Kah Shpirti i përhershëm.

Fluturoi përsëri: U zgjerua në perceptim kudoprezent.

Kush e di: Dihet veç nga ai që di.

73

*Ah, Dashuri! a do të mundnim ti dhe unë me Fatin të komplotojmë
Ta kuptonim plotësisht këtë Skemë patetike të Gjërave,
A nuk do ta shpartallonim atë copë-e-çikë – e pastaj
Ta riformësonim më afër Merakut të Zemrës?!*

FJALOR:

Dashuri!: Inteligjenca e Pafundme e Zotit e pasqyruar në krijim si Dashuria Kozmike, fuqia hyjnore e tërheqjes dhe e harmonisë.

Me Fatin: Me Ligjin Kozmik, parimin universal të karmës, të shkakut dhe efektit.

Këtë Skemë patetike të Gjërave: Planin pikëllues të ndërthurjes së dualiteteve nëpër gjithë kozmosin – të së keqes me të mirën, të vdekjes me jetën, të pikëllimit me qeshjen.

Ta shpartallonim atë copë-e-çikë: T'i shkatërronim të gjitha ngjarjet e padëshiruara në tokë.

Ta riformësonim më afër Merakut të Zemrës?!: Ta ribënim skemën e jetës në këtë botë sipas mostrës hyjnore të përsosmërisë të fshehur në thelbin e secilit shpirt.

74

Ah, Hëna e Kënaqësisë sime, që nuk njeh shuarje,

Hëna e Qiellit po lind edhe një herë:

Sa shpesh tash e tutje lindjen do ta shohë

Nëpër këtë Kopsht të njëjtë pas meje – kot!

FJALOR:

Hëna e Kënaqësisë sime, që nuk njeh shuarje: Lumturia e sigurisë në Zotin, e njohur veç për shpirtin e shpëtuar nga një kozmos kalimtar.

Hëna e Qiellit po lind edhe një herë: Fenomenet e universit të jashtëm, në kontrast, janë të lidhura me alternimet (ndryshimet e njëpasnjëshme: herë njëra, herë tjetra).

Sa shpesh tash e tutje lindjen do ta shohë: E prangosur, si të gjitha manifestimet natyrore, në përsëritje periodike.

Nëpër këtë Kopsht të njëjtë: Në tokë, planetin e zambakëve madhështorë, dhe të barërave të këqija të egra.

Do ta shohë . . . pas meje – kot!: Pse të kërkoj neglizhencë absolute? Unë jam një me Shpirtin, subtil përtej ndikimeve materiale.

75

*Dhe kur Ti me Këmbë shkëlqyese do të kalosh
Ndër Mysafirët e Shpërndarë si Yje në Bar,
Dhe në Misionin tënd të gëzueshëm ta arrish Pikën
Ku u bëra një – ktheje një Gotë të zbrazët!*

FJALOR:

Kur Ti me Këmbë shkëlqyese do të kalosh: Kur Vetja e zgjeruar – krejt tokësorja e shndërruar në dritë – do ta realizojë (rrokë, kuptojë) kudoprezencën.

Ndër Mysafirët e Shpërndarë si Yje në Bar: Shikimi astral i sheh shpirtrat që shkëlqejnë brenda trupave të ndryshëm, të shpërndarë nëpër kufizime të kësaj sfere të gjelbëruar të tokës.

Misionin tënd të gëzueshëm: Shërbimin e dashur që ia ofron njerëzimit nga shpirti yt i çliruar.

Pikën ku u bëra një: Vetëdija Kozmike, ku “Uni”, egoja e kufizuar, bëhet një me Kudoprezencën.

Ktheje një Gotë të zbrazët: Universi është zbrazur nga një ego kurdo që edhe një qenie njerëzore e gjen strehën përfundimtare në Shpirt.

Rubaijat e Omar Khajamit (vetëm vargjet)

51

*Gishti Lëvizës shkruan; dhe, pasi shkroi,
Vazhdon tutje: as gjithë Devotshmëria as Urtia jote
S'do ta joshin ta anulojë as gjysmë Vije,
As tërë Lotët e tu s'do ta shlyejnë asnjë Fjalë të tij.*

52

*Dhe ai Tas i përmbysur që e quajmë Qielli
Nën të cilin, të kafazuar e duke u zvarritur rrojmë e vdesim,
Mos i ço duart kah Ai për ndihmë – se Ai
Vepron pa ndikim si Ti apo Unë.*

53

*Me Argjilën e parë të Tokës Ato e bënë brumin e Njeriut të Fundit,
Dhe pastaj nga Korrja e Fundit e mbollën Farën:
Po, Mëngjesi i parë i Krijimit e shkroi
Atë që do të lexohet tek Agu i Fundit i Llogarisë.*

54

*Ja ku po ta them – Kur, duke ia nisur nga Qëllimi,
Mbi supet e Mëzit flakërues
Të Qiellit e Paruinit e Mushtarës u hodhën,
Në Komplotin tim të destinuar të Pluhurit e Shpirtit.*

55

*Vreshta e kishte nxjerrë një Fije; që sillet
E i kacavirret Qenies sime – le të përbuzet Sufiu;
Nga Metali im Bazë mund të gdhendet një Çelës,
Që do ta hapë Derën që ai e ulërin përjashta.*

56

*Dhe këtë unë e di: nëse ajo Drita e Vërtetë,
Zjarri i Dashurisë, apo Zemërimi më konsumojnë goxha,
Një shfaqje e rrufeshme e Saj brenda Tavernës e kapur
Është më mirë se në Tempull i humbur krejt.*

57

*Oh, Ti, që me Gropën e Kurthit dhe me Xhinin
Ma bllokove Rrugën në të cilën do të endesha,
A nuk do të më kapësh në Rrjetë me raund të Paracaktimit,
Dhe t'ia atribuosh Rënien time Mëkatit?*

58

*Oh, Ti, që e bëre Njeriun nga Toka më e ulët,
Dhe që Me Edenin e sajove Gjarprin;
Për tërë Mëkatin nga i cili Fytyra e Njeriut
Nxihet, Faljen e Njeriut jepe – dhe merre!*

59

*Dëgjo përsëri. Një mbrëmje në Përmbyllje
Të Ramazanit, para se të dilte Hëna më e mirë,
Në atë Shitore të vjetër të Poçarit rrija vetëm
Me Popullatën e argjiltë përreth në Rreshta.*

60

*Dhe, për çudi, ndër ata të Turmës Tokësore
Disa mund të shpreheshin lehtë, e të tjerë jo:
Dhe befas një më i paduruar klithi –
“Kush është Poçari, ju lutem, e kush Poçi?”*

61

*Pastaj tha një tjetër – “Sigurisht jo më kot
Substanca Ime nga Toka e zakonshme u mor,
Që Ai që në mënyrë subtile më bëri si Trajtë
Të më fuste në Tokën e zakonshme prapë.*

62

*Një tjetër tha – “Epo, kurrë një Djalë me disponim të keq
Nuk do ta thyente Kupën nga e cila pinte me Gëzim;
Athua Ai që e bëri Enën në Dashuri të pastër
Dhe Dekorim Artistik, pas një Tërbimi do ta shkatërrojë?!”*

63

*Askush s'iu përgjigj kësaj; por pas Heshtjes foli
Një Enë e ndërtuar më pahijshëm:
“Ata më përqeshin se jam anuar krejt e çrregullt;
Çka?! A u drodh pra Dora e Poçarit?”*

64

*Tha njëri – “Njerëzit e një Banakieri qejfprishur tregojnë,
Dhe ia shkarravisin fytyrën me Tymin e Ferrit;
Flasin për njëfarë Sprove të rreptë ndaj nesh – Uha!
Ai është Mik i Mirë, dhe gjithçka do të jetë në rregull.”*

65

*Pastaj tha një tjetër me një Psherëtimë të zgjatur,
“Argjila ime me kllapinë time të gjatë është tharë:
Por, mbushmë me Lëngun e vjetër të njohur,
Më duket se mund të shërohem dikur!”*

66

*Dhe gjersa Enët një nga një po flisnin,
Njëra e vërejtë Gjysmëhënë e vogël që të gjithë po e lypnin:
Dhe pastaj e shtynë njëri tjetrin: “Vëlla, Vëlla!
Vërja veshin kërcitjes së epoletës në supin e Derëtarit!”*

67

*Ah, jeta ime që po shuhet, me Rrushin furnizo
Dhe ma laj Trupin prej nga Jeta ka vdekur,
Dhe në një Qefin të Gjethëve të hardhisë mbështjellë,
Kështu më varros krah një Kopshti të ëmbël.*

68

*Ashtu që edhe Hiri im i varrosur si një Kurth
I Parfumit do të hidhet në Ajër,
Jo si Besimtar i Vërtetë që kalon atypari
Po do të kapet i pavetëdijsëm.*

[Vazhdim i konceptit në strofën e mëparshme]

69

*Vërtet Idhujt që i kam dashur kaq gjatë
I kanë bërë shumë padrejtësi Meritës sime në Syrin e Njerëzve:
Ma kanë zhytur Nderin në një Kupë të cekët,
Dhe ma shitën Reputacionin për një Këngë.*

70

*Vërtet, vërtet, Pendesë shpesh para
Se të betohem – por a isha esëll kur u betova?
E pastaj e pastaj erdhi Pranvera, dhe Trëndafili-në-dorë
Pendimi im i stërarnuar u gris copë-copë.*

71

*Dhe sado që Vera ka luajtur me ƒobesimtarin,
Dhe ma grabiti Rrobën time të Nderit – epo,
Shpesh them athua çka blejnë Vreshtarët
Një gjysmë kaq të çmuar sa Mallrat që i shesin.*

72

*Sa keq që Pranvera duhet të shuhet me Trëndafilin!
Që Dorëshkrimi erëmirë i Rinisë duhet të mbyllet!
Bilbili që ndër Degë këndonte,
Ah, nga erdhi, dhe kah fluturoi përsëri, kush e di!*

73

*Ah, Dashuri! a do të mundnim ti dhe unë me Fatin të komplotojmë
Ta kuptonim plotësisht këtë Skemë patetike të Gjërave,
A nuk do ta shpartallonim atë copë-e-çikë – e pastaj
Ta riformësonim më afër Merakut të Zemrës?!*

74

*Ah, Hëna e Kënaqësisë sime, që nuk njeh shuarje,
Hëna e Qiellit po lind edhe një herë:
Sa shpesh tash e tutje lindjen do ta shohë
Nëpër këtë Kopsht të njëjtë pas meje – kot!*

75

Dhe kur Ti me Këmbë shkëlqyese do të kalosh

Ndër Mysafirët e Shpërndarë si Yje në Bar,

Dhe në Misionin tënd të gëzueshëm ta arrish Pikën

Ku u bëra një – ktheje një Gotë të zbrazët!

Për botimin

Bibliografia

Yogananda, Paramhansa. *Wine of the Mystic — The Rubaiyat of Omar Khayyam: A Spiritual Interpretation*, Self-Realization Fellowship, 1994

Online

<https://botimetrb.wordpress.com/>

Licensimi

Ky publikim lëshohet nën licensën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>